

KOMUNA E PRISHTINËS  
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK  
DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHEM

**RAPORT I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR  
PLANI RREGULLUES I HOLLËSISHËM PËR ZONËN "FAKULTETI TEKNIK, NË  
LAGJEN 'BREGU I DIELLIT' " - PRISHTINË**



HARTUES:  
UNIVERSITETI "HASAN PRISHTINA"  
PRISHTINË

Tetor 2019

## PËRMBAJTJA

DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHEM .....	1
PLANI RREGULLUES I HOLLËSISHËM PËR ZONËN "FAKULTETI TEKNIK, NË LAGJEN 'BREGU I DIELLIT' " - PRISHTINË .1	
1. HYRJA .....	5
1.1. Qëllimi dhe fushëveprimi i VSM-së.....	5
1.2. Struktura e Raportit Mjedisor të zonës "FAKULTETI TEKNIK, NE LAGJEN BREGU I DIELLIT" .....	6
☒ Korniza ligjore dhe strategjike dhe informacionet në dispozicion.....	6
1.3. Korniza Ligjore .....	6
2. DIREKTIVA VSM E BE-SË.....	9
2.1. Direktiva të tjera të BE-së.....	9
2.2. Strategjia 2020 e BE-së .....	9
2.3. Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB.....	10
2.4. Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokollit i Kievit .....	11
2.5. Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse .....	12
3. GJENDJA AKTUALE – ANALIZA MJEDISORE SIPAS PRRZ .....	15
3.1. Topografia .....	15
3.2. Pozita gjeografike e Zonës .....	15
3.3. Qëllimet dhe objektivat specifike .....	17
3.4. Koncepti I zhvillimit hapësinor.....	17
3.5. Zhvillimi socio-ekonomik i zones .....	18
3.6. Organizimi hapësinor- tërësitë dhe njësitë hapësinore te zones .....	19
3.7. Intensiteti dhe shkalla e zhvillimit .....	19
3.8. Përbërja gjeologjike .....	19
3.9. Burimet e ujit.....	19
3.10. Përmbajtja funksionale rreth lokacionit .....	19
3.11. Biodiverziteti.....	19
3.12. Menaxhimi i mbeturinave dhe ujërave të ndotura.....	19
3.13. Vershimet.....	20
3.14. Infrastruktura e transportit.....	20
3.15. Kategorizimi i rrugëve, niveli I shërbimit dhe kuzifimi I shpejtësisë.....	20
3.16. Transporti publik.....	21
3.17. Shfrytëzimi i tokës dhe kushtet rregulluese hapësinore .....	22
3.18. Infrastruktura teknike; a. Ujësjiellësi .....	22

<b>4. SKENARËT DHE KORNIZA ZHVILLIMORE</b> .....	26
4.1. Sfidat, mundësitë dhe konkluzionet .....	26
4.2. Programimi i hapësirave .....	26
4.3. Skenarët e propozuar.....	26
4.4. Korniza zhvillimore; Qëllimet dhe objektivat specifike.....	28
<b>4.5.</b> Organizimi hapësinor- tërësitë dhe njësitë hapësinore.....	29
4.6. Intensiteti dhe shkalla e zhvillimit .....	29
4.7. Vëllimi dhe forma e strukturave .....	29
4.8. Kërkesa e përgjithsme për rregullimin e hapësirës .....	29
4.9. Shfrytëzimi I tokës dhe kushtet rregulluese hapësinore .....	30
<b>5. ANALIZA SWOT</b> .....	32
5.1. Zonat me Probleme Mjedisore .....	32
5.2. Zonat që vuajnë nga degradim i thellë mjedisor .....	32
<b>6. OBJEKTIVAT E VSM-SË PËR ZONËN E KAMPUSIT UNIVERZITAR</b> .....	34
<b>7. MASAT E NEVOJSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT</b> .....	36
7.1. Ndikimi në klimë .....	36
7.2. Mbrojtja e zonave të gjelbërta ekzistuese dhe zhvillimi i zonave të reja .....	36
7.3. Cilësia e ajrit në Zonë.....	36
7.4. Menaxhimi i mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme .....	36
7.5. Efektet kumulative .....	37
<b>8. MONITORIMI</b> .....	39
<b>9. PËRFUNDIME</b> .....	40
<b>LITERATURA</b> .....	41

## **Lista e shkutesave**

- AKMM** - Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit
- BE** - Bashkimi Evropian
- GIS** - Sistemit i Informacionit Gjeografik
- GNP** - Grimcat e Ngurta Pezull
- NOQ** – Ndotës Organik të Qëndrueshem
- OZHM** - Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
- PZHK** - Plani Zhvillimor Komunal
- UND** - Programi i Zhvillimit i Kombevetë Bashkuara
- UNEP** - Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara
- VNM** - Vlerësim i Ndikimit në Mjedis
- VSM** - Vlerësim Strategjik Mjedisor
- ZE** - Zona Ekonomike
- PRRH** - Plani Rregullues I Hollesishem

## 1. HYRJA

### 1.1. Qëllimi dhe fushëveprimi i VSM-së

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një proces sistematik për vlerësimin e pasojave mjedisore të një politike të propozuar, plani ose iniciativave të programit në mënyrë që të sigurojë se ato janë plotësisht të përfshira dhe të adresuara në mënyrë të përshtatshme në fazën më të hershme të vendim-marrjes në po të njëjtin nivel me konsideratat ekonomike dhe ato sociale (Sadler dhe Verheem, 1996). Qëllimi përfundimtar i VSM-së është që të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të kontribuojë për të promovuar qëndrueshmërinë. VSM ka për qëllim përmirësimin e planit ose programit, duke sugjeruar objektiva apo strategji të reja, si dhe duke bërë rishikimin e strategjive të propozuara dhe sugjerimin e atyre që duken të jenë më mirë në aspektin e rritjes së mundësive mjedisore dhe minimizimin e ndikimeve dhe rreziqeve. Rrjedhimisht, VSM duhet të fillojë me fillimin e hartimit të planit dhe të integrohet plotësisht në të (shih seksionin 1.2).

Në Kosovë, VSM është rregulluar me *Ligjin nr.03/L 230*, i cili përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurat për aplikimin e VSM-së. Në bazë të këtij ligji, VSM-ja duhet të ndërmerret për planifikimin e hapësirës dhe të qytetit, duke përfshirë planet zhvillimore komunale. Ligji i Kosovës për VSM-në është në pajtueshmëri me kërkesën e Bashkimit Europian të ashtu quajtur "Direktiva e VSM-së" (*Direktiva 2001/42/EC*), e cila identifikon elementet e mëposhtme kyçe të procesit të VSM-së:

- Përgatitja e një raporti të VSM-së në lidhje me ndikimet e konsiderueshme të draftit të planit ose programit (PP);
- Konsultimi i organeve relevante, dhe publikut të gjerë, për draftin e PP-së dhe raportin shoqërues të VSM-së;
- Marrja në konsideratë e raportit për VSM-në dhe rezultateve të konsultimit në vendimmarrje;
- Komunikimi i rezultateve të VSM-së dhe përfshirja e rezultatit të saj në PP.

Sipas Ligjit Nr. 03/L 230, VSM-ja është e detyrueshme për PP-të vijuese:

- PP-të që janë të përgatitura për planifikim hapësinor, planifikim të qytetit, shfrytëzim të tokës, bujqësi, pylltari, peshkatari, gjueti, energji, industri, miniera, komunikacion, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikacion, turizëm, dhe të përbejnë kornizën për projektet e ardhshme të zhvillimit të cilat i nënshtrohen VNM-së sipas Ligjit për VNM;
- PP-të të cilat, duke marrë në konsideratë lokacionin në të cilin realizohen, mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura të natyrës, mbi habitatet natyrore dhe në florën dhe faunën e egër.
- Llojet e tjera të PP-ve, vetëm nëse ato janë përcaktuara përmes "ekzaminimit" që kanë gjasa të kenë ndikime të konsiderueshme në mjedis

- Modifikimet e vogla të PP-së dhe PP-ja për zonë të vogël në nivel lokal, vetëm nëse ato janë përcaktuar përmes "ekzaminimit" që kanë gjasa të kenë ndikime të konsiderueshme në mjedis. Kështu, planet hapësinore për zonat e mbrojtura kërkojnë VSM, siç është specifikuar në kushtin e dytë më lartë.

### 1.2. Struktura e Raportit Mjedisor të zonës "FAKULTETI TEKNIK, NE LAGJEN BREGU I DIELLIT"

Ky raport është strukturuar si në vijim: **Kapitulli 2** ofron informacione mbi kornizën ligjore dhe strategjike. **Kapitulli 3** përshkruan të dhënat që janë në dispozicion dhe paraqet studimin bazë të mjedisit të Zonës. **Kapitulli 4** përshkruan problemet dhe mundësitë kyçe mjedisore, dhe objektivat e VSM-së që janë përcaktuar për Zonën. **Kapitulli 5** ofron një përmbledhje të përmbajtjes së draftit të Planit Rregullues të Hollesishëm të "Fakulteti Teknik, ne lagjen Bregu i Diellit". **Kapitulli 6** përmban rezultatin e vlerësimit të pajtueshmërisë së qëllimeve të zonës. **Kapitulli 7** dhe **Kapitulli 8** përmbajnë një vlerësim paraprak të ndikimeve mjedisore të draftit të kornizës së zhvillimit hapësinor, dhe përkatësisht draftet e strategjive dhe veprimeve për zbatim. **Kapitulli 9 ofron** një propozim për planin monitorues. Në fund, **Kapitulli 10** përmban përmbledhjen jo-teknike të raportit të VSM-së.

- **Korniza ligjore dhe strategjike dhe informacionet në dispozicion**

### 1.3. Korniza Ligjore

Tabela 2 ofron një pasqyrë të legjislacionit të Kosovës që përcakton objektivat për mbrojtje të mjedisit dhe politikat të cilat janë potencialisht relevante për Planin Rregullues dhe VSM-në.

**Tabela 2.** Ligjet përkatëse Mjedisore si qëllimi dhe fushëveprimi i tyre

Ligji	Qëllimi dhe Fushëveprimi
<b>LIGJ</b> Inr. <b>03/230</b> <b>PËR</b> <b>VLERËSIMIN</b> <b>STRATEGJIK</b> <b>MJEDISOR</b> <b>dhe Direktiva e VSM-së së</b> <b>BE-së (42/2001)</b>	Përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurat për zbatimin e VSM-së, si dhe përmbajtjen e raportit mjedisor.
<b>LIGJI</b> nr. <b>02/L-102</b> <b>për</b> <b>MBROJTJEN</b> <b>NGA</b> <b>ZHURMA</b>	Qëllimi i këtij ligji është shmangia, parandalimi ose zvogëlimi në baza prioritare i efekteve të dëmshme, duke përfshirë shqetësimin si rezultat i ekspozimit të zhurmës. Ky ligj do të ofrojë bazë për zhvillimin e masave për zvogëlimin e zhurmës së emituar nga burimet e mëdha, në veçanti në trafikun rrugor dhe hekurudhor dhe atë ajror, pajisjet e jashtme dhe industriale, makinerinë mobile dhe për burimet e tjera të ndotjes dhe shqetësimin të mjedisit nga zhurma.

<p><b>LIGJI nr. 02/L-116</b> <b>PËR KIMIKATE</b></p>	<p>Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë administrimin e qëndrueshëm të kimikateve, duke përfshirë masat për mbrojtjen e mjedisit dhe ekspozimin e njeriut ndaj substancës.</p>
<p><b>LIGJI nr. 03/L-025</b> <b>PËR MBROJTJEN E MJEDISIT</b></p>	<p>Ky ligj duhet të harmonizojë zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës duke sjellë gradualisht standardet e Bashkimit European për mjedis.</p>
<p><b>LIGJI nr. 03/L-043 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E INTEGRUAR TË NDOTJES</b></p>	<p>Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i ndërhyrjes së kontrollit të ndotjes që rrjedh nga veprimtaritë industriale, në veçanti duke parandaluar dhe reduktuar mbeturinat, emisionet në ajër, ujë dhe tokë.</p>
<p><b>LIGJI nr. 03/ L-104</b> <b>PËR MBROJTJE NGA RREZATIMI JO-JONIZUES,</b></p>	<p>Qëllimi i këtij ligji është që: të sigurojë pajtueshmërinë me normat dhe konventat ndërkombëtare në fushën e rrezatimit jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare, të sigurojë krijimin e</p>
<p><b>JONIZUES DHE SIGURINË NUKLEARE</b></p>	<p>një mjedisi të tillë të shëndetshëm, që t'i përballojë ndotjet dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe sigurinë Nukleare që është e përballueshme dhe konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, të krijojë autoritet dhe detyrime specifike të autoriteteve publike që janë përgjegjëse për prezantimin dhe fuqizimin gradual të standardeve të tilla; t'i përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e personave dhe ndërmarrjeve që preken nga aktivitete të tilla ose interesi në</p>
<p><b>LIGJI nr. 03/L-119</b> <b>PË PRODUKTE BIOCIDE</b></p>	<p>Qëllimi kryesor i këtij projektligji është të përcaktojë dhe të rregullojë kushtet për vendosjen në treg dhe shfrytëzimin e substancës(ve) aktive të përdorura për prodhimin e produkteve biocide në territorin e Republikës së Kosovës dhe me anë të kësaj të mbrohet shëndeti i njerëzve, kafshëve dhe mjedisit.</p>
<p><b>LIGJI nr. 03/L-160 PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA</b></p>	<p>Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë dhe garantojë të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit.</p>
<p><b>LIGJI nr. 03/L-214</b> <b>PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS</b></p>	<p>Qëllimi i këtij ligji është parandalimi ose zbutja e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë të kontribuoj në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.</p>

<p><b>LIGJI nr.03/L-233</b> <b>PËR MBROJTJEN E NATYRËS</b> natyror) dhe vlerat e saj.</p>	<p>Ky ligj do të përcaktojë një sistem për mbrojtjen e përgjithshme dhe ruajtjen e natyrës (të gjithë diversitetin biologjik dhe natyror) dhe vlerat e saj.</p>
<p><b>LIGJI nr.04/L-060 PËR MBETURINA</b></p>	<p>Ky ligj ka për qëllim të: 1. evitohet dhe zvogëlohet sa më shumë të jetë e mundur brezin e mbeturinave; 2. ripërdorë komponentët e përdorura nga mbeturinat; 3. zhvillimin e qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së burimeve njerëzore; 4. parandalimin e efekteve negative të mbeturinave në mjedis dhe në shëndetin e njeriut; 5. magazinimin përfundimtar të mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.</p>
<p><b>LIGJI nr. 04/L-120</b> <b>PËR MBROJTJEN E BIMËVE</b></p>	<p>Ky ligj rregullon të gjitha aktivitetet që lidhen me: 1. mbrojtjen e bimëve, produktet bimore dhe objektet e tjera të përfshira në prodhimin e bimëve; 2. identifikimin e masave për parandalimin e futjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm në bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera dhe për asgjësimin e tyre;</p>
<p><b>LIGJI nr. 2004/24</b> <b>PËR UJËRAT E KOSOVËS</b></p>	<p>favorizimin e mbledhjes dhe shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave me vendet e tjera; 4. financimin dhe kompensimin e punëve të ndërmarra për mbrojtjen e bimëve; 5. përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të subjekteve të përfshira në mbrojtjen e bimëve dhe në zbatimin e këtij ligji në Kosovë.</p>



## 2. DIREKTIVA VSM E BE-SË

Direktiva e BE-së 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis u aprovua më 27.06.2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Kjo direktivë nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlament i Evropian..., 2001) thotë që planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legislative, rregulluese ose administrative.

Një VSM është i obligueshëm për planet/programet si vijon:

- Përgatiten e planeve për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhim të mbeturinave/ ujit, telekomunikim, turizëm, planifikimin të qytetit & venditose shfrytëzime të tokës dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM);
- Janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve. Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet ta kryejn një procedurë të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet ka mundësi të kenë efekte domethënëse mjedisore. Nëse kanë efekte domethënëse nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

Procedura VSM mund të përmblihet si vijon: raporti VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativa të arsyeshme të planit ose të programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet e konsultimeve merrën parasysh para aprovimit. Kur të aprovohet plani ose programi, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e pa parashikueshme të pafavorshme në një fazë të hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

### 2.1. Direktiva të tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke ushqyrtuar çështjet mjedisore dhe të. Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve dhe të programeve, por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme.

### 2.2. Strategjia 2020 e BE-së

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura legislative të BE-së, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet,

objektivat dhe nismat më të mëdha<sup>1</sup> është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor me që bashkëpunimi rajonal me këtë rajonë është identifikuar si njëri prej prioriteteve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së (Komisioni Evropian, 2010 ) zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetete strategjisë janë "zhvillimi i shpejtë, i qëndrueshëm gjithëpërfshirës". Janë shtatë nisma të mëdha, prej të cilave *Evropa efikase sa ju përket burimeve dhe Një politikë industriale për epokën e globalizimit* janë drejtpërdrejt të lidhur me çështje të që ndrueshmërisë, por nismat e tjera si *Agjenda digjitale për Evropën, Unioni i përtëritjeve, Rinia në lëvizje, Një agjendë përshkathtësi dhe vende të reja pune dhe Platforma evropiane kundër varfërisë* dotë mundeshin poashtu të kontribuonin në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm po të zbatoheshin në mënyrë efikase. Në strategji poashtu përfshihen objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme sipër shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t'i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë siç është zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave të serrave, 20% rritje të shkallës së energjisë nga gjëra tepër të ritshme dhe nga efikasiteti i energjisë. Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

### 2.3. Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB

KB kan një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës, edhe pse Kosova nuk është shtet anëtar, KB vepron në Kosovë nën mandatin e misionit UNMIK në mënyrë që t'isigurojë kushtet për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe për avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mbledhën në NjuJork për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo nismë është bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit<sup>2</sup>. Janë 7 objektiva me qëllime specifike, një prej objektivave i kushtohet qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosja e qëllimeve në vijim:

- Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programete vendit dhe kthim i mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;
- Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme tek uji i sigurt i pijshëm dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;
- Deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetëte sëpaku 100 banorëve të lagjeve të varfra.

<sup>1</sup>[http://ec.europa.eu/europe2020/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm)

<sup>2</sup>[http://ec.europa.eu/europe2020/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm)

## 2.4. Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokollit i Kievit

### 2.4.1. Konventa Århus

Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit "Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Konventa Århus vendosë një numër të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNE CE mbi Qasjen...,1998) Nga palët në këtë Konventë kërkohet t'i hartoj në dis pozitat e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhene efektive. Konventa parashikon:

- Të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaji pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyen pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t'i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat i posedojnë;
- Të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet publike duhet t'i bëjnë përgatitjet që t'ia mundësojnë opinionit të influencuar dhe organizatave jo qeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim;
- të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipërpërmendura ose të drejtën mjedisorenë për gjithësi.

### 2.4.2. Konventa ESPOO dhe Protokollit i Kievit

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi..... Mjedisor, 1991) përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Poashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projektet të mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë dikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997. Siç thekson Marsden (2008).

### 2.4.3. Protokollit i Kievit

Është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, meqë dotë mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008). Protokollit është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve pjesëmarrëse në Konventën ESPOO, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga Palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësimi i Strategjiki Mjedisor (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (NMP) dhe prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin qëndrueshëm. Protokollit poashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit. Protokollit kërkon që vlerësimistrategjikimjedisittë kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për

bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industripërfshirë minierat, transport, zhvillimi rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzim të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratime zhvillimit të ardhshëm për projektet. Sugjerimet për promovimin e pjesëmarrjes publike dhe përfshirja e aktorëve po ashtu janë në përputhje me protokollin.

## 2.5. Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse

### 2.5.1. Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor

Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjinr. 03/L-106), ndërkaq në korrik të viti 2013 është aprovuar Ligji i ri i Planifikimit (Ligji Nr. 04/L-174) duke pasur si qëllim kryesor:

- Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;
- Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;
- Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet
- Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (Qendror dhe lokal) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Harta Zonale e Komunës, dhe Planet Rregulluese Urbane të Hollësishme. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrje të opinionit. PZHK si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton objektivat afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai duhet ta përfshijë periudhën prej së paku 8 vjetëve dhe ta përfshijë një Plan për zhvillimin e hapësirave urbane dhe fshatrave brenda komunës. Te gjitha nivelet e Planeve duhet të përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm si dhe për secilin Plan obligohet përgaditja e raportit të VSM paralelisht me Planin.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikën për zhvillim hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor, si dhe për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin e Kosovës. Ndërsa autoritetet lokale janë përgjegjës për zbatimin zhvillimet urbane të nivelit lokal të cilat duhet të jenë në harmonime politikën dhe programet nacionale si dhe duke rrespektuar përgjegjësitë që dalin nga Ligji Nr. 04/L-174.

### 2.4.2. Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (VSM)

Ligji Nr. 03/L-230 nënvizon rëndësinë e integritit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit gjatë përgatitjes, aprovimit dhe realizimit të Planeve dhe të Programeve përkatëse nëse është e qartë që këto të fundit kanë ndikime domethënëse në mjedis. Lista e Planeve dhe e Programeve të obligueshme është e përcaktuar në kuadër të ligjit. Ato Plane nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin VSM. Nëse mendohet që VSM nuk nevojitet vendimi për katë s' duhet të jetë në formë të shkruar dhe duhet t'i përfshijë arsyet e tij. Raport i VSM-së identifikon, përshkruan

dhe vlerëson ndikime të mundshme të rëndësishme në mjedis nga zbatimi i Planit ose Programit dhe vlerëson alternativat e arsyeshme. Kërkesat përcaktohen në Ligj në mënyrë që t'iu ofrojnë qasje në dokumente të VSM-së organeve këshilluese dhe opinionit të përgjithshëm. Projekti i dokumenteve VSM-së është një dokument për diskutim publik. Në kuadër të ligjit përcaktohet kërkesa të posaçme për raste të këshillimeve ndërkufitare. Para se të aprovohet raporti VSM, ministria duhet ta shqyrtojë atë dhe të pajtohet me të. Po ashtu janë përcaktuar procedurat për informimin lidhur me aprovimin e vendimeve, për monitorimin dhe mbikëqyrjen. Shtojcat e ligjit përmbajnë kritere të caktuara për përcaktimin e rëndësisë së mundshme të ndikimeve në mjedis dhe informatat e nevojshme që duhet të ofrohen në raportet VSM si edhe kriteret për vlerësimin e raporteve të VSM-së.

#### 2.4.3. Planet dhe programet e tjera të rëndësishme

Përveç legjislacionit raporti i VSM-së duhet të merr parasysh edhe Planin Hapsinor të Kosovës 2010-2020+, Strategjin për Mjedisin dhe Planie Veprimit në Mjedis, si dhe disa Plane, Programe dhe dokumente të ndryshme të politikave të përgatitura dhe të lëshuara rishtazi nga autoritetet nacionale dhe institucionet e tjera relevante për të vazhduar më tutje me zbatimin e objektivave strategjike dhe të kërkesave ligjore.

#### 2.4.4. Veprimet strategjike

Tabela 3 ofron një pasqyrë të veprimeve strategjike (politikat, planet dhe programet) që janë potencialisht relevante për të ndikuar në PRRH të "Fakulteti Teknik, ne Lagjen Bregu i Diellit". Pajtueshmëria e Planit Rregullues të të "Fakulteti Teknik, ne Lagjen Bregu i Diellit" me këto veprime (e ashtu quajtur "analizë e jashtme e pajtueshmërisë") do të vlerësohet në **Kapitullin 8**.

**Tabela 3. Veprimet strategjike relevante si dhe qëllimi dhe fushëveprimi i tyre**

<b>Veprimi strategjik Plani Hapësinor i Kosovës</b>	<b>Qëllimi dhe fushëveprimi 2010-2020+</b>
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet 2011 – 2020  Strategjia mjedisore për Kosovë	Kjo promovon interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim të përsheptuar ekonomik, më qëllim të ërmirësimit të cilesisë së jetës, por njëkohësisht duke mbrojtur resurset, trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Hartimi i Planit Hapësinor të Kosovës jep udhëzime për zhvillimin e ardhshëm hapësinor në nivel kombëtar, në shkallë komunale dhe urbane.  Ky është një dokument themelor për mbrojtjen e natyrës, i cili përcakton objektivat afatgjata për ruajtjen e biodiversitetit dhe diversitetit të peizazhit, vlerën e mbrojtur të natyrës, dhe gjithashtu mënyren e zbatimit në harmoni me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social, kulturor.  E hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit. Ajo paraqet bazën për hartimin e Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis.

	<p>Specifikon në detaje të gjitha aktivitetet e nevojshme për realizimin e Strategjise Mjedisore. Plani i Veprimit përmban programin operativ për arritjen e objektivave të Strategjise.</p>
--	--

### 3. GJENDJA AKTUALE – ANALIZA MJEDISORE SIPAS PRRZ

Ligji për VSM-në kërkon që Raporti i VSM-së të përfshijë një përshkrim të aspekteve relevante të gjendjes aktuale të mjedisit dhe evulimin e saj të mundshëm pa zbatimin e planit ose programit, si dhe një përshkrim të çfarëdo problemi ekzistues mjedisor. Ky kapitull përmbush këtë kërkesë përmes sigurimit të një përmbledhjeje koncize të aspekteve mjedisore të radhitura në Ligjin për VSM-në.

#### 3.1. Topografia

Zona ka karakteristika me pak thyerje të terrenit sa i përket topografisë së terrenit. Është një nga zonat me më pak përryerje të terrenit ku pjesa qendrore dhe ne vazhdim në të gjitha drejtimet është me pjerrësi të vogël. Vetëm në pjesën tjetër të rrugës në pjesën veriore të zonës terreni pësoi pak pjerrësi (në ngritje) sikurse edhe nga ana e rrugës, ku nga rruga në drejtim të brendësisë së zonës pëson pjerrësi të terrenit (në rritje).

#### 3.2. Pozita gjeografike e Zonës

4. Zona për të cilën është hartuar Plani Rregullues i Hollësishëm gjendet në zonën "**Fakulteti Teknik, ne lagjen Bregu I Diellit** ", dhe përfshinë një sipërfaqe prej S= 9.08 Ha.

Parcelat kadastrale janë në pronësi publike dhe private.

*Parcelat ku shtrihet ky plan kanë pronësi komunale dhe private, dhe gjenden në Zonën Kadastrale-Prishtinë.*

*Parcelat kadastrale brenda kufirit të hapësirës që trajtohet*

Z.K. Prishtinë				
	Nr.Parcelës	Pronari	Sip. m2	Verejtje
1	2735-1	P.SH.Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	26164	
2	10015-0	P.Sh.KK Prishtinë	67210	
3	2730-1	P.Sh.KK Prishtinë	7309	mungon ndarja- grafike
	2730-2	P.Sh.Shfrytëzues: Univerziteti i Prishtinës	10077	
4	2720-1	P.Sh.KK Prishtinë	17279	
5	2723-1	P.Sh.KK Prishtinë	8377	mungon ndarja -grafike
	2723-2	P.Sh.KK Prishtinë	1010	
6	2722-1	P.Sh.KK Prishtinë	8531	mungon ndarja -grafike
	2722-2	P.Sh.KK Prishtinë	590	
7	2724-0	P.Sh.KK Prishtinë	13841	
8	2725-1	Enver Krasniqi	6841	mungon ndarja- grafike
	2725-2	P.Sh.KK Prishtinë	899	
9	10007-0	P.Sh.KK Prishtinë	20322	

Tabela 2. Parcelat e lokacioni të kampusit






Foto 1. Gjendja eksistuese e lokacionit te fakultetit teknik me hapesirat percjellese




Foto 2. Gjendja e propozuar e lokacionit te fakultetit teknik me hapesirat percjellese



### 3.3 Qëllimet dhe objektivat specifike

Ndërtimi i Kampusit Tekniku ka për qëllim përmirësimin e kualitetit të studimeve përmes sigurimit të hapësirëve adekuate, bashkëkohore universitare për akomodimin e studentëve të Fakulteteve Teknike, Fakultetit të Shkencave Matematiko Natyrore dhe Fakultetit Ekonomik.

Objektivat specifike:

- Krijimi i një kampusi të hapur universitar me hapësirë publike të hapur për të gjithë
- Zgjerimi i Fakulteteve teknike,
- Ndërtimi i Fakultetit të ri të Shkencave Matematiko Natyrore
- Ndërtimi i Fakultetit të ri Ekonomik

### 3.4 Koncepti I zhvillimit hapësinor

Koncepti i propozimit është hapësira qendrore publike "Atriumi"- rreth të cilit përvijohen ndërtesat e fakulteteve të cilët e formësojnë një oborr publik të hapur për shfrytëzim nga studentë dhe shfrytëzues të tjerë. Një hapësirë e tillë duhet të jetë fleksibile për shfrytëzim të larmishëm: mësim në natyrë, pushim, lojë, aktivitete të ndryshme sociale si koncerte dhe performansa tjera në të hapur.

Atriumi nga ana e poshtme kufizohet nga bulevardi cili përveç ecjes dhe vrapimit, mundëson edhe zhvillimin e aktiviteteve mësimore të lidhura me fakultetet dhe laboratorët si psh ekspozita dhe panairë të shkencës, demonstrime të ndryshme, gara etj.

Kufizimi i atriumit me ndërtesat e fakulteteve është menduar të ndajë dinamikën e jetës intensive urbane në anën e jashtme dhe jetës më intime në anën e brendshme. Është e rëndësishme të mundësohet transparenca në përdhese dhe lidhja vizuale me anën e jashtme të kampusit dhe atriumit nga ana e brendshme. Kjo mund të arrihet me vendsojen e përmbajtjeve sociale në përdhese – si psh, biblioteka, kafene /restorante si dhe hapësirat e organizatave studentore.

Hapësira para ndërtesës ekzistuese e cila aktualisht përbëhet nga një parking dhe gjelbërimi do të shndërrohet në një park të vogël të hapur për shfrytëzim të lirë nga publiku



Foto 3 Adaptimi i originalit në zgjidhjen e re

### 3.5 Zhvillimi socio-ekonomik i zones

Zhvillimi social në lokacion, aktualisht është i ibazuar në funksionin e arsimit të lartë i cili zhvillohet brenda hapësirave të ndërtuara. Në hapësirat e jashtme, pa marrë parasysh se hapësira nuk shquhet me mundësi të optimale të shfrytëzimit, për shkak të mungesës së hapësirave të lira në lagjen e Matit, shumë banorë, të moshave të ndryshme, e shfrytëzojnë hapësirën e lirë për pushim dhe rekreacion, posacerisht prindët me fëmijë të vegjël dhe të moshuarit. Jeta sociale e studentëve në lokacion, për shkak të mungesës së hapësirave adekuate brenda ndërtesave ekzistuese, zhvillohet në kafenetë dhe restorantet në rrugën “Fadil Vata”, të cilat gjenerojnë edhe nje zhvillim ekonomik i lidhur me funksionin e arsimit të lartë. Brenda vet ndërtesave, në labororet e fakulteteve zhvillohet një aktivitet i kufizuar ekonomik i shërbimeve të testimit, certifikimit për materiale dhe produkte respektive. Zhvillimi i ardhshëm duhet të merr parasysh inkorporimin e aktivitetetve ekonomike brenda ndërtesave të fakulteteve si koncept i ri i arsimit universitar ku mësimi teorik përkehet me aktivitete direkte ekonomike në të cilat zbatohen njohuritë teorike.

### 3.6 Organizimi hapësinor- tërësitë dhe njësitë hapësinore te zones

Hapësira e kampusit është e organizuar si tipologji e bllokut të mbyllur në të cilin ndërtesat e fakulteteve e formësojnë perimetrin e bllokut me sipërfaqen e ndërtuar kurse oborri- atriumi, paraqet oborrin e brendshëm publik duke qartësuar kështu zonën tërësisht publike në pjesën e jashtme dhe zonën gjysëm publike të brendshme. Duke konsideruar sipërfaqen e madhe të ndërtesave, secila prej tyre mund të konsiderohet njësi hapësinore e cila konstituon fasadën e rrugëve në anën e jashtme, respektivisht hapësirës publike si dhe kufizojnë atriumin në anën e brendshme. Secila ndërtesë e ka qasjen vetanake - për këmbësorë dhe vetura dhe përmes hyrjes krijon relacion të ri në mes jetës publike në hapësirën e jashtme publike dhe formave të kombinuara publike dhe private të jetës, brenda ndërtesës.

### 3.7 Intensiteti dhe shkalla e zhvillimit

Intenziteti i shfrytëzimit të hapësirës mund të konsiderohet mesatarisht i ulët. Sipërfaqja e ndërtimit nën ndërtesa te reja është 13,374.0 m<sup>2</sup>, ndërsa nën ndërtesa ekzistuese është 9,881.0 m<sup>2</sup> dhe në total 23,255.0 m<sup>2</sup>

Shkalla e zhvillimit është mesatare me index të përgjithshëm të zhvillimit më të vogël se 1 . Një intenzitet dhe shkallë e tillë e zhvillimit respekton kontekstin ekzistues të lagjeve të banimit në të cilat shkalla e shfrytëzimit të tokës është e ulët, me një lartësi mesatare të ndërtimit.

Sipërfaqja gjelbëruese dhe absorbuese e parcelës është 34,678.00 m<sup>2</sup> vetwm gjelbrim (duke mos llogaritur rruget dhe trotoaret (d.m.th. rreth 40 %)

### 3.8 Përbërja gjeologjike

Prishtina është e vendosur në koordinatat 42 ° 40 '0 "Veri dhe 21° 10' 0" Lindje. Sipërfaqja e Komunës së Prishtinës është rreth 523 km<sup>2</sup>. Shtrihet në planin morfologjik të Kosovës dhe përfaqëson një plan aluvial të mbuluar me sedimente të liqeneve, dhe nga ana gjeologjike është një depresion tektonik, i cili është ngritur gjatë ndryshimeve të Oligo- Miocene. Klima është kontinentale, me dimra të ftohtë dhe verëra të nxehta, me mesatare të reshjeve prej 600 mm për vit.

### 3.9 Burimet e ujit

Në zone nuk ka burime të ujit dhe akumulime tjera, por zona furnizohet nga ujësjellësi i qytetit.

### 3.10 Përmbajtja funksionale rreth lokacionit

Zona ndodhet në qytetin e Prishtinës dhe është nën ndikimin e shumë faktorëve mjedisor por edhe nga faktorët tjerë orografik.

### 3.11 Biodiverziteti

Sipërfaqja e zonës është e mbuluar me lloje të ndryshme të bimëve barishtore. Ekzistojnë bimë drurore dhe shkurre në afërsi të zonës. Pasi disa nga rrugët rreth zones janë të gjelbëruara, atëherë vlen të theksohet se kemi një llojllojshmëri të botës bimore që gjenden në në zone e cila është edhe e mbjellur apo e kultivuar dhe për këtë duhet të merren masa adekuate për mbrojtjen e këtyre specieve nga ndotja.

### 3.12 Menaxhimi i mbeturinave dhe ujërave të ndotura

Menaxhimi apo grumbullimi i mbeturinave në zone bëhet nga kompania rajonale apo ndonjë ndërmarrje

tjetër private e cila eventualisht mund të ofroj menaxhim me të mire të tyre. Duhet të fillohet me pilot project të selektimit të mbeturinave sipas pëervoajve përendimore të menaxhimit, selektimit dhe asgjësimit të tyre. Vendosja e shporteve dhe kontanjerëve duhet të planifikohet parallel sipas standardeve dhe këndeve të cilat do të janë më të frekuentuara dhe duhet të mendohet edhe aspekti i qasjes së lehtë të makinerisë për zbrazje të kontajnerëve me mbeturina. Mbrenda zonës së kampusit duhet të punësohet një person përgjegjës për menagjimin e mbeturinave të ngurta, person i cili është në koordinim të ngushtë me kompanin e jashtme publike pran qytetit apo ndonjë ndërmarrje private. Duhet të caktohet edhe vendi i deponimit të materieve të rrezikshme në gjendje aggregate të ndryshme të cilat ndërkohë mund të hyjnë apo krijohen mbrenda kampusit. Atom und të janë nga më të ndryshmet, si; Bateri të ndryshme të makinave, Vajra të përdorura nga Automjetet e ndryshme, Vajra hidraulike, etjera. Keto selektohen mbrenda kampusit në hapësira të veqanta për mbeturina të rrezikshme dhe vendosen signale-shenja të cilat tregojnë llojin e mbeturinave të rresikshme. Këto mbeturina nuk lejohen të merren nga kompania e zakonit e mbeturinave, por duhet të mirren nga kompani e licensuar për mbeturina të rrezikshme.

Ndërsa ujërat e ndotura menaxhohen nga kompania rajonale e ujësjellësit Batllava. Ato së bashku me llojet e ndryshme bashkohen në një tubacion dhe shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të qytetit.

### 3.13 Vershimet

Zona e fakultetit teknik nuk është zone nën ndikimin e vërshimeve por vërehen në disa vende grryrjet e shkaktuara nga erozioni, andaj veprimi sa më i hershëm kundër erozionit do të ishte mas e nevojshme për këtë zone, sidomos gjatë gjurmëve.

### 3.14 Infrastruktura e transportit

Kampusi i Fakultetit Teknik kufizohet me rrugën "Fadil Vata " në njërin anë, e cila rrugë e ndanë kampusin me lagjen "Bregu i Diellit", për të vazhduar me rrugën "Xhevë Lladrovci" e cila rrugë e ndanë kampusin me lagjen e Ulpianës, kufizohet me rrugën "Arbenor dhe Astrit Dehari " e cila rrugë e ndanë me Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për tu kompletuar me kufizim me Lagjen e Profesorëve.

Kampusi i Fakultetit Teknik është i lidhur me trafikun urban përmes tri pikave dhe at në rrugën "Fadil Vata", në rrugën "Xhevë Lladrovci" dhe në rrugën " Arbënor dhe Astrit Dehari ", ndërsa hyrjen për automjete kampusi e ka nga " Arbenor dhe Astrit Dehari ". Brenda kampusit me sipërfaqe 90.080m<sup>2</sup> tani kemi rrugë në shfrytëzim të komunikacionit të përzier për automjete dhe këmbësorë që kryesisht u shërben studentëve dhe stafit akademik e teknik me sipërfaqe të rrugëve rreth 5.040m<sup>2</sup>, parkingje për automjete 2.410m<sup>2</sup>, shtigje e hyrje para objekteve 270m<sup>2</sup>. Meqenëse denivelimi nga rruga " Fadil Vata ", deri te stacioni në rrugën " Arbenor dhe Astrit Dehari " është mbi 18m, në pjesën e hyrjes për këmbësorë janë shkallët të shoqëruara me pushimore në sipërfaqe 520m<sup>2</sup>.

### 3.15 Kategorizimi i rrugëve, niveli I shërbimit dhe kuzifimi I shpejtësisë

Rrugët në kampus janë rrugë të nivelit lokal, me funksion të përzier dhe shrytëzohen prej këmbësorëve, automjeteve, me kufizim të shpejtësisë së lëvizjes maksimale 30 km/h.

Rrugët brenda kampusit janë të ngarkuara kryesisht me këmbësor, automjete të vogla dhe automjeteve të rënda, me pjesmarrje mesatarisht më të vogël se 10 automjete/24 orë.

Konstruksioni i poshtëm i rrugës duhet të dimensionohet dhe ndërtohet prej materialeve të forta gurorë, rezistuese ndaj thyerjes dhe ngricave sipas standardeve EN, i cili duhet të kalojë thellësinë e ndikimit të ngricave dhe ngarkesave të automjeteve me konstruksion të rruges me trashësi prej 1,0m.

Ngjeshja e materialeve jo të lidhura të kryhet në shtresa çdo 20cm dhe të arrihet ngjeshja e duhur sipas standardeve.

Konstruksioni i epërm i rrugës duhet dimensionohet dhe ndërtohet prej asfaltit me kualitet të lartë me përbërje të agregatit të rezistueshëm ndaj thyerjes dhe gërryerjes si dhe të bitumenit rezistues ndaj klimës si dhe në harmoni me standardet dhe rregulloret tjera teknike EN.

Largimi i ujërave nga sipërfaqja e rrugës - Ujërat e reshjeve duhet larguar sa më shpejt nga sipërfaqet e rrugës duke dimensionuar shimbledhësit në dy anët e rrugës dhe vendosur jo më larg se 30m njërin nga tjetrin.

Sipërfaqja e rrugës duhet të jetë me së paku 1% pjerrësi gjatësore dhe 2,5% pjerrësi tërthore të lidhura në gypa me diameter më të madh se DN350 dhe puseta me kapak të rezistueshëm nga ngarkesa prej 40 t.

#### **Trotualet, shiritat për këmbësor dhe për biçikleta**

Trotualet dhe shiritat për këmbësorë variojnë varësisht prej rolit të shtigjeve brenda kampsit por edhe të prurjeve nga pjesët e caktuara të qytetit në raport me qasjen në kampus. Shtigjet kryesore për këmbësorë janë prej 3-4 m, ndërsa ato sekondare janë 1.2 m.

#### **Objektet për largimin e ujit nga rruga**

Largimi i ujërave nëntokësore - Ujërat nëntokësore të largohen me gypa drenimi të lidhur në pusetat sipas kushteve teknike për kullimin e ujërave nga konstruksionet e rrugëve.

#### **Parkimi, vendndalimet për automjete, gjelbërim etj**

Komponentë kryesore e të gjitha vendëpakingjeve është gjelbërimi. Përgjatë parkingjeve janë planifikuar drunjë të cilët kanë aftësi përthithëse të pluhurit dhe gazërave.

#### **5.5 Sinjalizimi vertical, horizontal dhe semaforët**

Sinjalizimi horizontal dhe vertikal të projektohet sipas normave teknike për rrugët lokale mbrenda vendbanimeve dhe objekteve institucionale.

### **3.16 Transporti publik**

Llojet dhe vijat e transportit publik për autobusë; Linjat e transportit publik janë: 1, 2, 3, 3 A,3B, 3C, 4, 5, 7A,10..

#### **Vendndalimet për transport publik**

Në të tri rrugët kufizuese të kampusit gjendet pikat e stacioneve që lidhen me linjat përkatëse. (shih. Harta e transportit publik)

#### **Vendëpakingjet dhe garazhat publike**

Parkimi është planifikuar në garazha nëntokësore 16,450 m<sup>2</sup> për 580 garazha si dhe një pjesë mbi sipërfaqe të tokës rreth 100 VP.

Dimensionet minimale për hapësirat e parkimit në varg për automjete motorike standarde do të jenë si më poshtë:

Dimensionet e vend parkimeve: ☐ Vend parkimi në 90° - 250 cm x 455 cm; ☐ Vend parkimi në 60° - 250 cm x 485 cm; ☐ Vend parkimi në 45° - 250 cm x 485 cm ; ☐ Vend parkimi në 30° - 250 cm x 425 cm; ☐ Vend parkimi paralel - 215 cm x 640 cm; ☐ Vend parkimi i rrethuar - 270 x 550 cm

Parkingjet në sipërfaqe të projektohen dhe ndërtohen me material të rezistueshëm ndaj kushteve klimatike dhe ngarkesave, me ramje gjatësore për largimin e ujërave atmosferike së paku 1% dhe tërthore 2,5 %.

Hyrja në parkingjet nëntokësore është me rampa të cilat duhet të ken dimensione dhe ramje gjatësore në përputhshmëri me norma teknike.

#### **Vend-parkimet për qasje të personave me aftësi të kufizuara,**

Përveç hapësirës normale për parkim të automjetit, përmbajnë edhe hapësirë shtesë për hyrje/ dalje nga automjeti; së paku 5% e numrit të gjithmbarshëm të parkingjeve duhet të jenë për qasje të personave me aftësi të kufizuara;



### 3.17 Shfrytëzimi i tokës dhe kushtet rregulluese hapësinore

#### Kushtet ndërtimore

Në sipërfaqen prej 90,800 m<sup>2</sup>, është propozuar një zhvillim me indeks të shputës  $I_{sh}=0,3$  (30%), dhe sipërfaqja e ndërtuar 83,443 m<sup>2</sup>, përfshi sipërfaqen ekzistuese të fakulteteve teknike - ndërtesa dhe labororet, prej 25,560 m<sup>2</sup>. Indeksi i ndërtimit është  $I_n = 1.2$ . Etazhiteti maksimal i propozuar është P+6 dhe lartësi maksimale deri në 28.0 m'. Kjo shpërndarje lejon mundësinë e parashikimit edhe të zgjerimit të Kampusit në të ardhmen në pjesën lindore kryesisht për zgjerimin e sipërfaqeve të fakulteteve të inxhinierisë. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZH) është i zgjidhur në nivel të planit, përmes përcaktimit të gabariteve të ndërtesave. Ndryshimi i shfrytëzimit të parcelës mund të bëhet deri në  $\pm 2\%$ , nga ai i që është i përcaktuar përmes gabariteve të përcaktuara, gjithmonë brenda normave teknike të planifikimit.

### 3.18 Infrastruktura teknike; a. Ujësjellësi

Gjendja Ekzistuese -Infrastruktura e ujësjellësit ne Kampusin e Fakulteteve Teknike përbëhet nga rrjeti i ujësjellësit primar, sekundar dhe terciar, është i rrethuar me rrjetin primar me gypa AC DN250, paralel me rrugët „Fadil Vata“, Xhevë Lladrovci“ dhe me gypa AC DN200 ne rrugen „Arbënor dhe Astrit Dehari“, rrjeti sekundareshte nga PVC DN150 dhe është mbrenda kampusit përpara objektit të Fakultetit Teknik nga i cili furnizohet me ujë, ndërsa rrjetin terciar GMS DN50 furnizon Labororet



Fig. 4 Rrjeti ekzistues i furnizimit me ujë

Normat e furnizimit duhet të llogaritet për numrin e studentëve mbrenda Kampusit të Fakultetit Teknik 20litra për student në ditë, për mirëmbajtje të hapësirave publike, sipërfaqet e gjelbra, rrugët dhe sheshet me 1.50 litër/m<sup>2</sup>, si dhe sasia e ujit për shuarjen e zjarreve e cila duhet të llogaritet sipas normave dhe rregulloreve.

#### b. Kanalizimi

Largimi i ujërave fekale- Infrastruktura e kanalizimit në kampusin e Fakultetit Teknik e ka rrjetin e largimit të ujërave fekale nga Fakultetet Teknike me gypin DN200.

### c. Largimi i ujërave atmosferik

Rrjeti i kanalizimit atmosferik me diameter DN400 shtrihet nën rrugët ekzistuese në mes objektit të Fakulteteve Teknike dhe Laboratoreve në oborrin e kampusit.

Ujërat fekale nga objektet e planifikuara do të largohen nëpër gypin DN400, ky gyp shtrihet paralel me rrugën „Xhevë Lladrovci“ e kalon nëpër oborrin e kampusit.

Për të dimensionuar rrjetin e largimit të ujërave atmosferike të llogaritet sasia e ujërave të formuara nga reshjet atmosferike në objektet e planifikura të merret intensiteti 168 litra/(s x ha).

Rrjeti i ri për largimin e ujërave atmosferike sipërfaqore dhe nëntokësore do të derdhen në gypin e ujërave të kanalizimit atmosferik DN600 i cili shtrihet nën rrugën „Xhevë Lladrovci“.

### d. Energjia elektrike

Propozimet teknike janë dhënë bazuar në procedurat bazike që aplikohen gjatë planifikimit urban të rrjetit shpërndarës, e që janë:

- Mbledhja e shënimeve për rrjetin ekzistues
- Analiza e rrjetit ekzistues
- Ngarkesa aktuale dhe ajo e parashikuar
- Planifikimi optimal i lokacionit, madhësisë dhe zonës së TS 10(20)/0.4kV.
- Planifikimi i rrjetit shpërndarës 10(20)kV.
- Planifikimi i rrjetit shpërndarës 230/400V.
- Analizat e rrjedhave të fuqisë.

Furnizimi ekzistues i ndërtesave të Fakultetit Teknik është nga nënstacionet 10/0.4kV të cilat janë të vendosura në ndërtesën e laboratorëve si është dhënë në Figurën 1. Në ndërtesë janë të vendosura dy nënstacionet 10/04 kV secili me fuqi S=630 kVA, njeri nënstacion e furnizon ndërtesën qendrore të Fakultetit Teknik dhe i dyti e furnizon ndërtesën e laboratorëve. Sipas Planit rregullues të hollësishëm të zonës Fakulteti Teknik, Bregu i Diellit, është planifikuar që në këtë zonë të jenë edhe ndërtesat e Fakultetit Ekonomik (FE), Fakultetit të Shkencave Matematiko Natyrore (FSHMN, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) si dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM).

Duke u nisur nga gjendja ekzistuese si dhe propozimi i zhvillimit të ardhshëm, furnizimi me energji elektrike duhet të bëhet nga NS 110/10(20) kV/kV Prishtina 7 dhe në përputhje me dy rekomandime të dhëna në vazhdim:

1. Rekomandimet e master planit për zhvillimin e sistemit distributiv të Kosovës deri më vitin 2023, që përfshinë:

- Kalimin nga rrjeti shpërndarës 10kV në rrjetin shpërndarës 20kV
- Zëvendësimin e NS 10/0.4kV me ata 20/0.4kV

2. Rregulloret e IEC, IEEE dhe ANSI që për projekte të reja në vende urbane, linjat e furnizimit me energji elektrike dhe ato të rrjetit telekomunikues të ndjekin të njëjtën trasë dhe të realizohen në të njëjtën kohë.

Nënstacionet 10(20)/0.4 kV duhet të kenë fuqi të mjaftueshme për të furnizuar të gjithë konsumatorët me tension 230/400 ±10%V. Në rast se transformatorët furnizojnë ndërtesa publike, me qëllim të ruajtjes së ambientit përreth objekteve, atëherë kur të krijohen mundësitë teknike, rekomandohet që transformatorët të vendosen në brendi të objektit të ndërtuar.

Nënstacionet e vendosur në brendi të objektit do të duhet të plotësojnë kushtet teknike të parapara me standarde për objekte të tilla, që janë:

Vendi i montimit të NS të ketë qasje për pirun karrocë, të jetë i mbrojtur nga vërshimet dhe të ketë ventilim.

#### **e. Energjia e Termike - Kapacitetet e nevojshme**

Dimensionimi i tubacionit të ngrohjes do të bëhet në bazë të sasisë së nevojshme për çdo objekt, me parametra të ujit primar nga Termokosi 130/70 oC. Kalkulimet e bëra të përafërta për objektet sipas projektit të dhënë janë afërsisht 30 W/m<sup>3</sup>.

Te vendosja e tubave nën tokë, duhet patur parasysh që ti ikim ujërave nëntokësor, në mënyrë që mos i ngarkojmë punët ndërtimore dhe ngarkesat e furnizimit me ujë të ngrohtë.

Tubacionet e paraizoluara duhet të jenë të punuara nga shkumë të poliuretanit, e cila është e futur me presion, në mes të tubit të çelikut dhe shtresës mbrojtëse të plastikes në pjesën e jashtme. Këto tubacione duhet të kenë atestet e kualitetit të materialit dhe të jenë standardizuar, pra ti plotësojnë normal dhe standardet e bashkësisë evropiane.

Pozita e tubacioneve është minimum nën koten H = -1.00 m, çka edhe shtrirja nën rrugët nuk paraqitet ndonjë rrezik nga shembja e dheut dhe vibracionet e mundshme nga komunikacioni rrugor, sepse janë marre parasysh ngarkesat e tokës, dhe tubacioneve përcjellëse përgjatë rrugës.

I tërë instalimi duhet të kryhet kryesisht sipas dokumentacionit të projektit detal të punuar, kurse material i nevojshëm duhet të jetë i klasit të parë dhe komfort standardeve të BE-s dhe të posedoj certifikatat e kualitetit të materialeve.

Tubacionet qendrore duhet të vendosen në lokalitetet me dendësi më të madhe të ngarkese termike, në mënyrë që shpenzimet e transportit të nxehtësisë, të jenë sa më të ulëta. Për shkak të vendosjes së tubacioneve në dhe duhet të merret parasysh pozita, niveli dhe kahjet e rrjetit:

1. Rrjeti i kanalizimit atmosferik,
2. Rrjeti i kanalizimit fekal;
3. Rrjeti elektrik
4. Rrjeti i ujësjellësit,
5. Rrjeti i telefonisë fikse
6. Mjetet e mundshme kabllorike etj.





Fig.5 Gjendja ekzistuese e furnizimit me ngrorje ne objektet ekzistuese

KAPACITETET E NEVOJSHME PER FURNIZIM SIPAS OBJEKTEVE															
Nr rendor	Blokuri	Destinimi	Sipërfaqja e bllokut (m <sup>2</sup> )	Indeksi i shfrytëzimit të ngjashmërisë	Sipërfaqja e shpërndarjes (m <sup>2</sup> )	Etazhiteti	Numri i kateve	Sipërfaqja e zhvilluar e objekteve (m <sup>2</sup> )	Lartësia e katit (m)	Nxehtësia specifike për metër kub (W/m <sup>3</sup> )	Nxehtësia e nevojshme për ngrorje (W)	Nxehtësia e nevojshme për ngrorje (kW)	Nxehtësia e nevojshme për ngrorje (MW)	Dimensioni i kycjes	
			N	ISHN	P		SZhO	h	q	Qng	Qng	Qng			
1	FSHMN	FSHMN obj 1	2,400	100%	2400	P+4	5	12000	4	30	1440000	1440	1.44	DN 100	
2		AMFITEATRI	1,450	100%	1450	P+0	1	1450	4	30	174000	174	0.174	DN 40	
3		FSHMN MULTI	529	100%	529	P+4	5	2645	4	30	317400	317	0.317	DN 50	
<b>Total</b>	<b>FSHMN</b>		<b>4,379</b>		<b>4379</b>			<b>16095</b>			<b>1931400</b>	<b>1931</b>	<b>1.931</b>		
1	EKONOMIKU	EKONOMIKU OBJ 1	1,950	100%	1950	P+4	5	8800	4	30	1056000	1056	1.056	DN 80	
2		MBIKALIMI	210	100%	210	P+3	4	840	4	30	100800	101	0.101	DN 32	
3		EKONOMIKU OBJ 2	1,950	100%	1950	P+3	4	7800	4	30	936000	936	0.936	DN 80	
4		AMFITEATRI	525	100%	525	P+0	1	525	4	30	63000	63	0.063	DN 25	
<b>Total</b>	<b>EKONOMIKU</b>		<b>4,635</b>		<b>4635</b>			<b>17965</b>			<b>2155800</b>	<b>2156</b>	<b>2.156</b>		
1	FIEK+FNA	FIEK zgjerimi OBJ.1	1,950	100%	1950	P+6	7	12700	4	30	1524000	1524	1.524	DN 100	
2		FIEK zgjerimi OBJ.2	1,730	100%	1730	6	6	10380	4	30	1245600	1246	1.246	DN 100	
3		AMFITEATRI	740	100%	740	P+0	1	740	4	30	88800	89	0.089	DN 32	
4		FIEK zgjerimi OBJ.1	1,950	100%	1950	P+6	7	13650	4	30	1638000	1638	1.638	DN 100	
5		FIEK zgjerimi OBJ.2	1,730	100%	1730	6	6	10380	4	30	1245600	1246	1.246	DN 100	
<b>Total</b>	<b>FIEK+FNA</b>		<b>8,100</b>		<b>8100</b>			<b>47850</b>			<b>5742000</b>	<b>5742</b>	<b>5.742</b>		
1	Sipërfaqja ekzistuese	FNA exist	14,353	100%	14353	1	1	14353	4	30	1722360	1722	1.722	DN 80	
2		FIEK Laborator exist	11,200	100%	11200	1	1	11200	4	25	1120000	1120	1.120	DN 80	
3		FIM exist	1,339	100%	1339	P+3	4	5356	4	25	535600	536	0.536	DN 65	
4		AMFITEATRI exist	738	100%	738	P+1	2	1476	4	20	118080	118	0.118	DN 80	
5		AMFITEATRI exist	772	100%	772	P+0	1	772	4	20	61760	62	0.062	DN 32	
<b>Total</b>	<b>Sipërfaqja ekzistuese</b>		<b>28,402</b>		<b>28402</b>			<b>33157</b>			<b>3557800</b>	<b>3558</b>	<b>3.558</b>		
<b>Total urban</b>			<b>45516</b>		<b>45516</b>			<b>115067</b>			<b>9829200</b>	<b>13387</b>	<b>13.4</b>		

Tab. 2 Kapacitetet e nevojshme per furnizim sipas objekteve

## 4. SKENARËT DHE KORNIZA ZHVILLIMORE

### 4.1. Sfidat, mundësitë dhe konkluzionet

Një nga kushtet esenciale për të arrijtur kualitet të lartë të arsimit universitar është hapësira kualitative e cila mundëson edhe kushtet optimale për studime por edhe reformimin e studimeve të Zgjerimi i hapësirave të Universitetit të Prishtinës në vitet e fundit paraqet një sfidë për autoritetet e Universitetit dhe Komunës së Prishtinës. Këto sfida lidhen me mundësitë financiare dhe kufizimet në lidhje me disponueshmërinë e tokës ndërtimore. Meqenëse Komuna e Prishtinës ka shumë pak tokë të disponueshme në kuadër të territorit urban, shfrytëzimi hapësirave të pandërtuara dhe densifikimi i ndërtimit janë opsione të cilat Komuna i ka konsideruar si opsione për adresimin e problemit të zgjerimit të UP-së.

Në anën tjetër, mungesa e tokës ka kufizuar edhe shfrytëzimin e e financave të planifikuara nga UP si dhe mundësinë e shfrytëzimit të donacioneve nga BE ose donatorë të tjerë.

Lokacioni i përcaktuar nga Komuna, është parë si mundësi për zgjerimin e ardhshëm të hapësirave të UP-së. Përveç sipërfaqes së madhe të lirë, lokacioni është i pajisur me infrastrukturë, në afërsi të qendrës studentore dhe përmbajtjeve publike në rrethinë, janë arsye vendimtare pse lokacioni duhet t'i kthehet funksionit të arsimit universitar. Kësaj duhet shtuar edhe kthimin e ndërtesës së mensës së studentëve në të cilën aktualisht është e vendosur Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë.

### 4.2. Programimi i hapësirave

Programimi i hapësirave është bërë në bazë të standardeve për ndërtesa të arsimit të lartë të mara nga Metric Handbook. Programimi është orientues dhe i shkoqitur në grupet e hapësirave të përgjithshme, hapësirave të mësimi – salla, laboratore, biblioteka, kabinete, hapësirat sociale dhe hapësirat ndihmëse dhe hapësirat e komunikimit. Në fazën e dizajnit arkitektonik ato mund të detajizohen më tutje varësisht nga hulumtimi i mëtejshëm dhe diskutimet me shfrytëzuesit e ardhshëm të hapësirës - studentët dhe stafi mësimor.

Programimi dhe distribuimi i hapësirës së ndërtuar dhe hapësirës së lirë të gjelbër, ndjekë logjikën e strukturës ekzistuese urbane në rrethinën e kampusit – të lagjeve të banimit Ulpiana dhe Bregu i Diellit si dhe Qendrës Klinike Universitare. Në sipërfaqen prej 87,000 m<sup>2</sup>, është propozuar një zhvillim me indeks të shputës  $I_{sh}=0,3$  (30%), dhe sipërfaqja e ndërtuar 82,700 m<sup>2</sup>, përfshi sipërfaqen ekzistuese të fakulteteve teknike - ndërtesa dhe labororet, prej 25,560 m<sup>2</sup>. Indeksi i ndërtimit është  $I_n=1.2$ . Etazhiteti maksimal i propozuar është P+6 dhe lartësi maksimale deri në 28.0 m'. Kjo shpërndarje lejon mundësinë e parashikimit edhe të zgjerimit të Kampusit në të ardhmen në pjesën lindore kryesisht për zgjerimin e sipërfaqeve të fakulteteve të inxhinierisë.

### 4.3. Skenarët e propozuar

Skenari I - zhvillimi sipas projektit origjinal 1974 - Ky skenar është analizu për të provuar adaptimin në situatën aktuale ekzistuese - përfshi ndërtesat dhe infrastrukturën, nevojat e ardhshme për zhvillim, dhe fakultetet të cilat do të vendosen në këtë kampus. Ky plan ishte punuar para se të definohej ndërtohej rrjeti i sotëm i rrugëve që e rrethojnë lokaconin. Sipas këtij skenari ndërtesat e fakulteteve vendosen në pjesën qendrore të lokacionit, kurse periferia mbetet e e lirë, por mjaft afër tri rrugëve rrethuese. Kurse kah rruga Xhevë Ladrovci ndërtesa e përbashkët për të tri fakultetet.

Duke marrë parasysh kërkesat e sotme për zgjerimin e hapësirave të ndërtuara të UP, ky skenar nuk mund të aplikohet për shkak të kërkesave të ndryshme hapësinore të fakulteteve. Deri sa në zanafillën

e vet plani ka paraprë vendosjen e tre fakulteteve teknike afërsisht të ngjajshme përka procesi mësimor, tani kërkesat janë për dy fakultete shtesë të cilat kanë karakter tjetër prej atyre teknike gjë që shprehet edhe në kërkesat për hapësirë. Në anën tjetër ky koncept nuk lejon fleksibilitet në zhvillim dhe ndërtim në faza.

Koncepti original e parasheh hapësirën e ndërtuar të ndarë nga konteksti i qytetit ku ndërtesat kanë komunikim shumë të dobët me rrugët rrethuese për shkak të largësisë së hyrjes. Në kuptim të urbanitetit dhe integritit të kampusii me qytetin, ky skenar nuk është i përshtatshëm. Dhe hapësira publike rrethuese nuk është shumë e përshtatshme për shfrytëzim, për shkak të zhurmës në rrugë dhe pamundësisë së kontrollit.




Fig. 6 Skenari I - zhvillimi përqendruar

Skenari II - zhvillimi i periferik me oborr të brendshëm. Ky skenar ka për qëllim definimin e kampusit përmes zhvillimit përgjatë rrugëve në distanca të përshtatshme ndaj rrugëve rrethuese për të minimizuar ndikimin negativ të trafikut- zhurma dhe ndotja e ajrit. Krijimi i një hapësire të brendshme publike ka për qëllim mundësimin e jetës publike në hapësirën publike te kampusit ku studentët përveç mësimit mund të zhvillojnë edhe aktivitet shoqërorë në hapësirën e jashtme - si pushimi, loja, tubimet, aktivitete mësimore në të hapur etj. Ky skenar mundëson një fleksibilitet të zhvillimit ashtu që t'i përshtatet nevojave të tashme dhe të ardhshme të zhvillimit.






Fig. 7 Skenari II - zhvillimi periferik

#### 4.4. Korniza zhvillimore; Qëllimet dhe objektivat specifike

Ndërtimi i Kampusit Tekniku ka për qëllim përmirësimin e kualitetit të studimeve përmes sigurimit të hapësirëve adekuate, bashkëkohore universitare për akomodimin e studentëve të Fakulteteve Teknike, Fakultetit të Shkencave Matematiko Natyrore dhe Fakultetit Ekonomik.

Objektivat specifike:

- Krijimi i një kampusi të hapur universitar me hapësirë publike të hapur për të gjithë
- Zgjerimi i Fakulteteve teknike,
- Ndërtimi i Fakultetit të ri të Shkencave Matematiko Natyrore
- Ndërtimi i Fakultetit të ri Ekonomik

Koncepti i zhvillimit hapësinor

Koncepti i propozimit është hapësira qendrore publike "Atriumi"- rreth të cilit përvijohen ndërtesat e fakulteteve të cilët e formësojnë një oborr publik të hapur për shfrytëzim nga studentë dhe shfrytëzues të tjerë. Një hapësirë e tillë duhet të jetë fleksibile për shfrytëzim të larmishëm: mësim në natyrë, pushim, lojë, aktivitete të ndryshme sociale si koncerte dhe performansa tjera në të hapur.

Atriumi nga ana e poshtme kufizohet ngabulevardi cili përveç ecjes dhe vrapimit, mundëson edhe zhvillimin e aktiviteteve mësimore të lidhura me fakultetet dhe laboratorët si psh ekspozita dhe panairë të shkencës, demonstrime të ndryshme, gara etj. Kufizimi i atriumit me ndërtesat e fakulteteve është

mennduar të ndajë dinamikën e jetës intensive urbane në anën e jashtme dhe jetës më intime në anën e brendshme. Është e rëndësishme të mundësohet transparenca në përdhese dhe lidhja vizuale me anën e jashtme të kampusit dhe atriumit nga ana e brendshme. Kjo mund të arrihet me vendsojen e përmbajtjeve sociale në përdhese – si psh, biblioteka, kafene /restorante si dhe hapësirat e organizatave studentore.

#### 4.5. Organizimi hapësinor- tërësitë dhe njësitë hapësinore

Hapësira e kampusit është e organizuar si tipologji e bllokut të mbyllur në të cilin ndërtesat e fakulteteve e formësojnë perimetrin e bllokut me sipërfaqen e ndërtuar kurse oborri atriumi, paraqet oborrin e brendshëm publik duke qartësuar kështu zonën tërësisht publike në pjesën e jashtme dhe zonën gjysëm publike të brendshme. Duke konsideruar sipërfaqen e madhe të ndërtesave, secila prej tyre mund të konsiderohet njësi hapësinore e cila konstituon fasadën e rrugëve në anën e jashtme, respektivisht hapësirës publike si dhe kufizojnë atriumin në anën e brendshme.

Secila ndërtesë e ka qasjen vetanake - për këmbësorë dhe vetura dhe përmes hyrjes krijon relacion të ri në mes jetës publike në hapësirën e jashtme publike dhe formave të kombinuara publike dhe private të jetës, brenda ndërtesës.

#### 4.6. Intensiteti dhe shkalla e zhvillimit

Intensiteti i shfrytëzimit të hapësirës mund të konsiderohet mesatarisht i ulët. Sipërfaqja e ndërtimit në ndërtesa të reja është 13,374.0 m<sup>2</sup>, ndërsa në ndërtesa ekzistuese është 9,881.0 m<sup>2</sup> dhe në total 23,255.0 m<sup>2</sup>

Shkalla e zhvillimit është mesatare me index të përgjithshëm të zhvillimit më të vogël se 1.0 . Një intensitet dhe shkallë e tillë e zhvillimit respekton kontekstin ekzistues të lagjeve të banimit në të cilat shkalla e shfrytëzimit të tokës është e ulët, me një lartësi mesatare të ndërtimit. Sipërfaqja gjelbëruese dhe absorbuese e parcelës është 34,678.00 m<sup>2</sup> vetëm gjelbërues (duke mos llogaritur rruget dhe trotoret (d.m.th. rreth 40 %)

#### 4.7. Vëllimi dhe forma e strukturave

Vëllimi dhe forma e strukturave është përcaktuar me mënyrën e zhvillimit si tipologji e bllokut të mbyllur si dhe duke marrë parasysh strukturën ekzistuese të ndërtuar. Shtrirja e ndërtesave është lineare përgjatë rrugëve rrethuese dhe vijës ndërtimore, kursë vija e brendshme ndërtimore mundëson arkitektëve të zhvillojnë format dhe vëllimet arkitektonike të cilat nuk e kufizojnë kreativitetin. Kufizimi i vetëm është ruajtja e atriumit si hapësirë lidhëse në mes të ndërtesave të fakulteteve të reja dhe atyre ekzistuese.

#### 4.8. Kërkesa e përgjithshme për rregullimin e hapësirës

##### **a. Kërkesa minimale për vendparkingje**

Sipas UA 08/2017 standardi për bruto të sipërfaqes për ndërtesat e fakulteteve dhe instituteve është 1 VP/100 m<sup>2</sup>. Parkimi është planifikuar në garazhe nëntokësore si dhe një pjesë (15%) mbi sipërfaqe të tokës. Planifikimi i garazhës nëntokësore është bërë për të liruar hapësirën për këmbësorë dhe çiklistë dhe të ruhet identiteti i lokacionit si një hapësirë ku këmbësori është në qendër të lëvizjes. Në hapësirat e parkingjeve janë paraparë edhe parkingjet për personat me kërkesa të veçanta.

1 UA 08\_2017. Fq 95

Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP) është 20% që është nën standardin e 80%.

**b. Sigurimi i ndriçimit natyror**

Kompozimi i ndërtesave bazuar në gjendjen ekzsituose si dhe në bazë të karaktersitkave të lokacionit bën që të gjitha ndërtesat të jenë të ekspozuara ndaj diellit në nivel maksimal sipas kërkesës. Kjo munëson që faqet e ndërtesave të kenë gjatë gjithë kohës ndriçim natyror. Nuk ka ndonjë element që bën të ndërhyje në rrafshin e ndriçimit natyror.

**c. Peizazhi, ndriçimi publik dhe mobileria urbane**

Kërkesat për peizazh

- Duhet të sigurohet qasje për të gjithë, përmes sigurimit të shkallëve, rampave (me gardh) ku ka ndryshime të nivelit
- Duhet të evitohen pengesat në vijat e lëvizjes
- Duhet të përdoren materiale të forta, jo të rrëshqitshme për dysheme si: guri i përpunuar, pllaka argjilore, betoni e të ngjashme
- Duhet të përdoren materialet me teksturë që ndihmojnë orientimin gjatë lëvizjes për të gjithë, përfshi personat me nevoja të veçanta
- Ndriçimi publik duhet të mundësojnë sigurinë në hapësirën publike, potencojë materialet e peizazhit (të forta dhe të buta) dhe minimizojë hijet e thella
- Duhet të realizohet drenazhi për të siguruar rrjedhën e ujit atmosferik në sipërfaqen e të tokës.
- Lokacioni i vendeve për ulje duhet të ofrojë zgjedhje për diell, hije si dhe të mundësohet strehim nga të reshurat

Kushtet për vendosje të mobiliarit urban

Mobiliari duhet:

- të jetë i thjeshtë dhe i qëndrueshëm
- të jetë në harmoni me dizajnin urban të kampusit
- gjatë pajisjes së hapësirave publike, dizajni dhe zgjedhja e mobiliarit urban të paraqesë vepra të artit public
- Nuk preferohet përdorimi i materialeve të cilat ndikojnë në perceptimin e vështirë të hapësirës

**4.9. Shfrytëzimi I tokës dhe kushtet rregulluese hapësinore**

**a. Kushtet ndërtimore**

Në sipërfaqen prej 90,800 m<sup>2</sup>, është propozuar një zhvillim me indeks të shputës  $I_{sh}=0,3$  (30%), dhe sipërfaqja e ndërtuar 83,443 m<sup>2</sup>, përfshi sipërfaqen ekzistuese të fakulteteve teknike - ndërtesa dhe laboratorët, prej 25,560 m<sup>2</sup>. Indeksi i ndërtimit është  $I_n=1.2$ . Etazhiteti maksimal i propozuar është P+6 dhe lartësi maksimale deri në 28.0 m'. Kjo shpërndarje lejon mundësinë e parashikimit edhe të zgjerimit të Kampusit në të ardhmen në pjesën lindore kryesisht për zgjerimin e sipërfaqeve të fakulteteve të inxhinierisë.

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZH) është i zgjidhur në nivel të planit, përmes përcaktimit të gabariteve të ndërtesave. Ndryshimi i shfrytëzimit të parcelës mund të bëhet deri në  $\pm 2\%$ , nga ai i që është i përcaktuar përmes gabariteve të përcaktuara, gjithmonë brenda normave teknike të planifikimit.

**b. Peizazhi, ndriçimi publik dhe mobileria urbane**

Kërkesat për peizazh

- Duhet të sigurohet qasje për të gjithë, përmes sigurimit të shkallëve, rampave (me gardh) ku ka ndryshime të nivelit
- Duhet të evitohen pengesat në vijat e lëvizjes
- Duhet të përdoren materiale të forta, jo të rrëshqitshme për dysheme si: guri i përpunuar, pllaka argjilore, betoni e të ngjashme
- Duhet të përdoren materialet me teksturë që ndihmojnë orientimin gjatë lëvizjes për të gjithë, përfshi personat me nevoja të veçanta
- Ndriçimi publik duhet të mundësojnë sigurinë në hapësirën publike, potencojë materialet e peizazhit (të forta dhe të buta) dhe minimizojë hijet e thella
- Duhet të realizohet drenazhi për të siguruar rrjedhën e ujit atmosferik në sipërfaqen e të tokës.
- Lokacioni i vendeve për ulje duhet të ofrojë zgjedhje për diell, hije si dhe të mundësohet strehim nga të reshurat

## 5. ANALIZA SWOT

Më poshtë paraqiten problemet më të rëndësishme mjedisore, zonat mjedisore dhe faktorët avantazhues, përkeqësues, kërcënues dhe mundesi për permiresim.

### 5.1. Zonat me Probleme Mjedisore

Ky seksion bënë një përmbledhje të analizës së mësipërme të kushteve mjedisore në zonën në fjalë dhe vë në dukje:

- Zonat që vuajnë nga një degradim i thellë mjedisor apo që po kalojnë një shok mjedisor;
- Zonat me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, të cilave mund të pësojnë ndryshime të pakthyeshme të ekosistemeve, nëse nuk u ofrohet një mbrojtje më e mirë mjedisore; dhe
- Përmbledhje të natyrës dhe shkallës së ndikimeve të mundshme në mjedis, nisur nga përshkrimet e bëra në këtë kapitull.

### 5.2. Zonat që vuajnë nga degradim i thellë mjedisor

Në fakt në zonën në fjalë edhe pas përfundimit të skenarit II të paraqitur, nuk do të kemi degradime të dukshme mjedisore.

Duhet kihet kujdes gjatë shakarkimeve të ujërave të ndotura nga kanalizimet që hidhen në të me rrjetin e kanalizimit të qytetit. Pastaj duhet të mbahet kujdes I shtuar me emituesit eventual të cilet mund të rrisin shkallën e ndotjes së ajrit mbrenda zones e cila pastaj mund të ket ndikime edhe jashtë zones.

Problemet mjedisore të identifikuar të menaxhimit të mbetjeve, të ngurta apo të lëngëta, si dhe ndotja e ajrit janë të trajtueshme në se investimet kryhen në kohe dhe ne mënyrë efektive. Me këtë planë janë trajtuar:

- furnizimin me ujë;
- menaxhimin e ujërave të ndotura;
- manaxhimi i integruar i mbetjeve të ndryshme.

Deri më tani nuk rezulton të ketë studime që të lidhin në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndikimin e cilesise se mjedisit, studime kryesisht për cilesin e ajrit, ujit të pijes, apo zhurma.



### Analiza SWOT

<p><b>Përparsitë</b>                  Kushte të përshtatshme fiziko-gjeografike për avansimin dhe plotësimin e nevojave të zgjerimit të ndertesave për disa njësi akademike,                  Interesim në rritje i qytetarve, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile për mjedisin                  Trajtimi i problemeve dhe sfidave mjedisore në PRRZ                  Legjislacion mjedisor dhe planifikimi hapsinor i zhvilluar dhe i përmirësuar;                  Përfshirja e ekipeve të kualifikuara në zbatimin e planeve dhe hartimin e projekteve të rëndësishme në kuadër të PRRZ-së;                  Rritje e hapësirave të gjelbërta</p>	<p><b>Dobësitë</b>                  Mungesa e disa informatave për thellim të analizave për zhvillimet e planifikuara me PRRZ.                  Motivim i ulët në segment të caktuar të administratës publike dhe qeverisjes lokale ;                  Manaxhim eventuale i dobët i mbeturinave dhe trajtimi eventuale i ujërave të ndotura para se të shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të qytetit.</p>
<p><b>Mundësitë</b>                  Marrja e masave për mbrojtje dhe zhvillim të qësjtjeve mjedisore;                  Krijimi i një forumi mbrenda Kampusit gjithë përfshirës për një kualitet të jetës më të mirë dhe edukim mjedisor;                  Bashkëveprim i kordinuar me zonat për rreth të komunës;                  Përmirësimi i shërbimeve në transportin njerëzor brenda zonës;                  Përfshirja e mundësive të riorganizimit të hapësirave të gjelbra dhe rekreative (parqe, kënd lojrash, sipërfaqe dhe fusha sportive për studentë).</p>	<p><b>Kërcënimet</b>                  Ndikim të lehtë në balancin ekologjik;                  Ndikimi i lehtë në ekosisteme, biodiversitet, florë dhe faunë;                  Konflikte eventuale në lidhje me çështjet e pronësisë;                  Mos realizimi në përpikëri i masave adekuate për eliminimin apo minimizimin e masave mbrojtëse në mjedisin e zonës së kampusit univerzitar.</p>

## 6. OBJEKTIVAT E VSM-SË PËR ZONËN E KAMPUSIT UNIVERZITAR

Duke u bazuar në qëllimin e VSM-së, që përkon edhe me qëllimin e mbrojtjes mjedisore të vetë zonës, janë përcaktuar objektivat mjedisore të VSM-së për këte zonë. Edhe objektivat mjedisore qëndrojnë po njëjloj për Planet e niveleve tjera. Për më tepër, këto objektiva janë ndërtuar në përputhje me politikat e strategjitë mjedisore kombëtare, me Planin Hapësinor të Kosovës, si dhe me qëndrimet e sektorëve përkatës (që preken nga objektivat). Për çdo objektiv janë listuar ndikimet e mundëshme të Planit në mjedis, nëse objektivi nuk realizohet, pra nëse nuk merren masat zbutëse, eliminuese apo parandaluese të dëmit mjedisor.

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në objektiva lokale të nivelit komunal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të jetë i definuar si:

**Objektivi Mjedisor 1 (OM1) – Ajri:** Përbushja e objektivave afatmesme për sasinë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, sipas kufijve maksimalë e normave të lejuara nga Bashkimi Europian.

**Objektivi Mjedisor 2 (OM2) – Uji:** Zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në këte zonë, mbi burimet dhe trupat ujqorë sipërfaqësorë e nëntokësorë, përfshirë ujin e pijshëm.

**Objektivi Mjedisor 3 (OM3) – Biodiversiteti:** Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, shërbimeve të tyre dhe garantimit të aftësisë vetëripërtitëse të mjedisit.

**Objektivi Mjedisor 4(OM4) – Peizazhi dhe Ekosistemet:** Konservimi dhe manaxhimi inteligjent i peizazhit, si matricë bazë për sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të ekosistemeve.

**Objektivi Mjedisor 5 (OM5) – Ndryshimet klimatike:** Realizimi i masave dhe infrastrukturës për të mos kontribuar në ndryshimet klimatike dhe efektin serë, si dhe për të parandaluar, apo zbutur efektet negative nga ndryshimet klimatike

**Objektivi Mjedisor 6 (OM6) – Cilësia e jetës:** Garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore në këte zonë.

- Zhvillimi i mëtejshëm i vlerave, ku të gjithë aktorët e kryera të drejtën e tyre për të ditur, për t'u dëgjuar, për t'u dëgjuar dhe për të ndikuar në vendimet që ndikojnë në jetën dhe tendencat e tij. Një nga qëllimet globale është se gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti ne kemi pjesëmarrje të cilësisë;
- Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e intensiv dhe ndryshimet në strukturën socio-ekonomik, përfshijnë zhvillimin e barabartë në kuadër të zonës;
- Për të krijuar kushte për një rritje të përhershme në punësim, luftimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit, zhvillimi dinamik i ekonomisë dhe nivelit të jetës zhvillimin socio ekonomik;
- Rritja e vazhdueshme e sigurisë në të gjitha dimensionet (krijimi i sigurisë për edukim themelor, siguri sociale dhe fizike, siguri të mjedisit etj);
- Zhvillimi i një partneriteti global për zhvillim.

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetes në zonë (rritja e sigurisë,

shtimi i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësim i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

Në mënyre të përmbledhur, objektivat për mbrojtjen e mjedisit në kuadrin e Planit rregullativ të hollesishëm të zones, mund të përmbledhen si më poshte:

1. Pakësimi i sasisë së mbetjeve të ngurta dhe manaxhimi i integruar deri në selektim të tyre;
2. Krijimi i një zone të qëndrueshme univerzitare dhe të shëndetshme;
3. Përmirësimi i cilësisë së ajrit, përfshirë reduktimin e zhurmave në gjitha burimet e mundshme mbrenda kampusit;
4. Kursimin e energjisë dhe pakësimi i emisioneve të gazeve serrë;
5. Reduktimi i intensitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit; ecje të këmbësorve dhe qarkullimit me bicikleta mbrenda dhe jashtë Kampusit Univerzitar.

## 7. MASAT E NEVOJSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Në këtë kapitull mbi masat e nevojshme të mbrojtjes së mjedisit do të analizohen dhe jepen propozime adekuate të mbrojtjes së mjedisit mbrenda dhe afër zonës së Kampusit univerzitar.

### 7.1. Ndikimi në klimë

Aktivitetet të cilat do të zhvillohen brenda hapësirës së zonës, vlerësohet se nuk ka indikacione se me aktivitetin aktual dhe ato që do të ketë në perspektivë të ndikojnë në klimën globale, pasi që nuk ka afër ndonjë industri apo objekt industrial që do të emitonte gazra të serrës në atë masë sa të ketë ndikim në klimën globale. Lehtësues do të jetë fakti se mbrenda zonës së kampusit do të instalohet ngrohja qëndrore përmes sistemit të ngrohjes përmes koo-gjenerimit të energjisë nga Termo Elektrana e Obiliqit.

### 7.2. Mbrojtja e zonave të gjelbërta ekzistuese dhe zhvillimi i zonave të reja

Destinimet për shfrytëzim dhe të planifikuar të hapësirave të gjelbërta të propozuara nga PRRZ mbrenda zonës së kampusit tokës sipas idesë projektuese duhet të implementohet me përpikëri dhe pastaj të mbrohen nga degradimet e faktorit njeri apo nga mos mirëmbajtja e tyre. Komuna duhet që në kuadër të zbatimit të planit të ketë në prioritet projektet si:

- Projekte gjelbrimit konform PRRZ dhe mirëmbajtjen konform planit apo skenarit të propozuar,
- Projekte të reja gjelbruese apo mure gjelbëruese.

### 7.3. Cilësia e ajrit në Zonë

Në këtë zonë kalojnë disa korridore të rëndësishme të qarkullimit të cilat kanë një intensitet të konsiderueshem të cilat janë një element që tregon se ka shkarkim të konsiderueshem të gazrave në atmosferë si dhe lirim të zhurmave të ndryshme që vijnë nga trafiku i rrugor rreth e përfaqë zonës. Si rrjedhim mund të kemi ulje të cilësisë së ajrit në përgjithësi, veçanërisht për Pb, SO<sub>x</sub>, NO<sub>x</sub>, të cilat aktualisht janë brenda normave të BE-së dhe normave të Kosovës. Zbatimi i standardeve më strikte për shkarkimet e ndotësve në ajër nga automjetet, përmirësimi dhe kontrolli i cilësisë së karburanteve djegëse dhe menaxhimi më i mirë i trafikut, përfshirë përdorimin e biçikletave. Sepse, grimcat e imëta PM<sub>10</sub> (të ngurta, të lëngshmeose gaz) mund të depërtojnë në mushkëri duke shkaktuar efekte anësore shëndetësore.

### 7.4. Menaxhimi i mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme

Menaxhimi apo grumbullimi i mbeturinave në zone bëhet nga kompania rajonale apo ndonjë ndërmarrje tjetër private e cila eventualisht mund të ofrojë menaxhim më të mirë të tyre. Duhet të fillohet me pilot projekte të selektimit të mbeturinave sipas përvojave përendimore të menaxhimit, selektimit dhe asgjësimit të tyre. Vendosja e shporteve dhe kontenjerëve duhet të planifikohet paralel sipas standardeve dhe këndeve të cilat do të janë më të frekuentuara dhe duhet të mendohet edhe aspekti i qasjes së lehtë të makinerisë për zbrastje të kontejnerëve me mbeturina. Mbrenda zonës së kampusit duhet të punësohen persona përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave të ngurta, persona të cilët janë në koordinim të ngushtë me kompanin publike pranë qytetit apo ndonjë ndërmarrje private. Duhet të caktohet edhe vendi i deponimit të materieve të rrezikshme në gjendje agregate të ndryshme të cilat ndërkohë mund të hyjnë apo krijohen mbrenda kampusit. Ato mund të janë nga më të ndryshmet, si;

bateri të ndryshme të makinave, Vajra të përdorura nga automjetet e ndryshme, vajra hidraulike, etj. Këto mbeturina nuk lejohen të merren nga kompania e zakonshme e mbeturinave, por duhet të mirren nga kompania e licensuar për mbeturina të rrezikshme.

### 7.5. Efektet kumulative

VSM-ja nuk do të kufizohet vetëm në analizën e elementeve individuale të planit rregullativ të zones së kampusit univerzitar, por duhet të bëjë gjithashtu edhe një vlerësim të përgjithshëm në vazhden e të gjitha aktiviteteve dhe politikave të cilat përfshihen në Planin Rregullativ të Zonës.

Tab.4 . Matrica e përmbledhjeve të efekteve kumulative të të gjitha elementeve të HZK-së në komponentet mjedisore

Komponentet mjedisore	Kushtet zhvillimore dhe masat e PRRZ					Vlerësimi i efekteve kumulative
	Rrugët e planifikuara	Rrugët qarkorre rreth zonës	Zonat e planifikuara të ndërtimeve rreth zonës	Zonat ekonomik e dhe industriale	Gjelbrimi	
Emetimi i gazrave serrë	0	-	+	-	+	Pa ndonjë efekt domethënës
Burimet natyrore	+	0	-	+	+	Pozitive
Toka	+	0	+	-	+	Pozitive
Biodiversiteti	0	-	0		+	Pa ndonjë efekt domethënës
Uji	0	0	+		+	Pa ndonjë efekt domethënës

Në këtë Raport ndikimet mjedisore kumulative percaktohen si një kombinim i ndikimeve të zbatimit të veprimeve të PRRZ në aspekte të ndryshme të mjedisit. Gjatë implementimit të kushteve zhvillimore, impaktet mjedisore kumulative variojnë sipas aspekteve individuale të mjedisit. Kur vleresohen impaktet mbi token, ajrin, ujin dhe faktorët klimatik, biodiversitetit, impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si shuma e impakteve të të gjitha masave, si të tilla në vlerësimin e impakteve kumulative mbi:

- Impakte mbi ajrin, shkarkimet e ndotësve që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen; dhe
- Impakte mbi burimet natyrore si burimet ujore, minerale dhe resurseve tjera të cilat kombinohen;
- Mbi token, zona tokë bujqësore dhe e pyjeve e fragmentuar për shkak të integritetit të strukturave të infrastrukturës së re që kombinohen si efekte;
- faktorët klimatik, shkarkimet e gazerave serrë që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen.

Nga aspekti i impakteve mbi ajrin dhe faktorët klimatik, impaktet kumulative si shumë e impakteve të të gjithë veprimeve të PRRZ janë të rëndësishme për realizimin e objektivave mjedisore:

- shkarkimet limiteve të ndotësve
- menaxhimin e mbetjeve inerte dhe
- sasia vjetore më e lartë e shkarkimit të gazeve serre.

Në vlerësimin e impakteve mbi ujin, natyrën, trashëgiminë kulturore dhe peisazhin, efekteve kumulative zakonisht nuk mund të shprehën si një shumë e impakteve të gjithë veprimeve për të arritur synimet e PRRZ. Kur vlerësohen efektet kumulative në aspektet e përmendura më sipër, karakteristikat e një impakti individual që kontribuon në efektet kumulative janë shumë të rëndësishme. Këto janë përgjithësisht karakteristika në të cilat impaktet ndryshojnë njëri nga tjetri sipas vendit (impakt direkt dhe në distance) dhe kohës (afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë, përkohësisht dhe permanent) të efekteve.

Nëse vlerësohen efektet mbi shëndetin njerëzor, efektet kumulative të PRRZ shprehën si efekte të kombinuara kumulative dhe zakonisht referohen për:

- zvogëlimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të bezdisjes akustike-zhurmave;
- zvogëlimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të ajrit të ndotur në mjedis; dhe
- masat e marrura në PRRZ që lehtësojnë veprimtari shlohëse/pushuese dhe rekreative në një mjedis.

Masat për të arritur synimet e PRRZ janë pozitive nga aspekti i impakteve mbi popullsinë dhe asetet materiale, nëse efektet kumulative të tyre kontribuojnë në arritjen e kohezionit social, sigurinë dhe qëndrueshmërinë.

## 8. MONITORIMI

Për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve, monitorimi i aspekteve të mjedisit është element kryesor. Në ligjin e "Vleresimit Strategjik Mjedisor", kërkohet monitorimi i pasojave të ndjeshme mjedisore ose shëndetësore të zbatimit të planit apo programit, në mënyrë që të identifikohen në fazë të hereshme pasojat negative të paparshikuara dhe me qëllim marrjen e masave rregulluese.

E njejta kërkesë është parashikuar në nenin 10 të Direktives së BE për VSM-n. Sipas kësaj direktive, me qëllim që të shmangen dublikimet në procesin e monitorimit, mund të përdoret sistemi aktual i monitorimit, nëse konsiderohet i përshtatshëm.

Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është MMPH-ja nëpërmjet AKMM Agjensisë Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit, e cila zbaton Monitorimin në bashkëpunim me institucionet përkatëse të Ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal.

Me qëllim që HZK-ja të zbatohen me efektivitet dhe të realizohen objektivat dhe synimet që janë përcaktuar në Plan, është e domosdoshme dhe siç e parashtruam edhe më sipër; është kërkesë ligjore, që të monitorohet zbatimi i kushteve të PRRZ, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis.

Për të qenë sa më racional dhe efektiv në monitorimin e mjedisit, do të referohemi atyre treguesëve që kanë rezultuar nga objektivat dhe synimet që janë përcaktuar për mbrojtjen e mjedisit dhe kapitullin mbi ndikimet dhe masat zbutëse të PRR. Plani Monitorimit përmbledh shumë tregues që përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të elementeve të mjedisit.

Realizimi me sukses i kësaj ndërmarrje kërkon angazhimin e disa institucioneve të cilët duhet të bashkërendojnë aktivitetet përkatës monitoruese nën drejtimin e Agjensisë Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit.

Mbështetur në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin për VSM dhe VNM, Komuna e Prishtinës ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryhen në kuadrin e zbatimit të PRRZ.

Komuna e Prishtinës ka karakter administrativ dhe pa struktura të plota dhe të afta për të kryer veprimtari si monitorimi mjedisor dhe për rrjedhojë, nuk mund të mbulojë me kapacitetet dhe burimet e saja njerëzore dhe financiare, të gjithë këtë veprimtari. Megjithatë ajo, duke angazhuar Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit dhe struktura të tjera në vartësi të saj, mund të kryej një pjesë të programit të monitorimit si cilësinë e ndërtimeve në zonë, ecurinë e pyllëzimit dhe gjelbërimit, zgjerimit të parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra, ecurinë e nderimit të rrugëve të reja përfshirë edhe ato për qarkullimin me bicikleta dhe të tjere indikatorë që janë paraqitur në programin e monitorimit të PRRZ.

Rezultatet e monitorimit, komuna e Prishtina sipas ligjit për VSM-n, duhet të publikoj në mënyrë periodike çdo vit. Për elementet e tjera të mjedisit duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushën e VSM për monitorimin dhe rezultatet të përcillen Agjensisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor të publikoj në kuadër të Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Republikën e Kosovës.

## 9. PËRFUNDIME

Qëllimi kryesor i VSM-së për Planin Rregullues të Hollesishëm - PRRH- të zonës së kampusit univerzitar është që të siguroj mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm gjatë zbatimit të kushteve zhvillimore dhe masave për gjithë territorin e zonës.

VSM përkufizohet si:

- Instrument kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendim-marrjen. Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesëmarrje që përdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara.
- Instrument i cili do të sigurojë udhëzime për menaxhimin e qëndrueshëm të aspekteve dhe konsideratave mjedisore të PRRH të zonës së kampusit universitar;
- Instrument që do të jep udhëzime për përfshirjen e çështjeve mjedisore në projektet të cilat do të realizohen në të ardhmen;
- Raporti i VSM-së propozon rregullore institucionale për menaxhimin e qëndrueshëm të aspekteve mjedisore të zonës.

PRRH i zonës prezanton Kushtet zhvillimore të përgjithshme, kushtet zhvillimore ku hyn gjitha kushtet ndertimore, si dhe masat për zhvillimet e planifikuara.

Një sfidë e veçantë mbetet zbatimi i kushteve zhvillimore dhe masave mjedisore në praktikë gjatë implementimit të Projektit të kampusit univerzitar, pra zhvillim të barazpeshuar dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbërta, krijimin e zonave rekreative dhe përmirësimin e treguesëve mjedisorë të zonës.

### Rekomandimet që dalin nga VSM-ja janë:

- Gjatë realizimit të korridoreve rrugore dhe infrastrukture të jenë pjesë e kushteve zhvillimore dhe masave edhe ndërtimi i korridoreve ekologjike;
- Planifikimi i masave dhe kushteve adekuate sipas normave të emitimit të ndotësve mbrenda zonës së kampusit të Teknikut;
- Kushte dhe masa për menaxhim të mbeturinave të ngurta mbrenda zonës, dhe riciklimimin e tyre,
- Kushte dhe masa për menaxhim të mbeturinave të rrezikshme mbrenda zonës dhe zbatimin e tyre konforme standardeve të BE,
- Kontrollimin e vazhduar të nivelit të zhurmës, dhe transportit mbrenda zonës.
- Lidhja e ngrohjes së qytetit me zonën e kampusit të Teknikut, si një dimension i rëndësishëm i reduktimit të ndotjes ndotjes dhe ndikimit në ekosisteme në zonën e kampusit univerzitar;



## LITERATURA

1. American Planning Association (Steiner Frederick and Butler Kent eds.). 2010.
2. Standartet e planifikimit dhe projektimit urban, Ufo University Press.
3. Assessment Study for the Proposed Eastern Industrial Park Njiru area, Nairobi County;
4. Konventa e UNECE Mbi Qasjen në Informacione, Pjesëmarrjen Publike në Vendim-marrje dhe Qasjen në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (Konventa Aarhus), 1998;
5. Ernest A. Lowe (1997-2001) Eco-industrial Park Handbook for Asian Developing Countries;
6. Agjensia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit. Raport i Gjendjes së Monitorimit të Mjedisit per vitin 2010.
7. Agenda 21, UN-Habitat (2009). Planning for Sustainable Cities, UN-Habitat. Nairobi, Kenya.
8. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (2011). Strategjia për Mjedisin 2013-2022). Prishtinë, 2013;
9. Berisha S., Baftjari I., Sokoli A., Berisha E. - 2019 Strategic Environmental Assessment (SEA) Analysis for the Municipal Development Plan (MDP) of Ferizaj Municipality. Medwell publications. Journal of Engineering and Applied Sciences. ISSN: 1816 -949X;
10. Berisha S., Baftjari I., Sokoli A., Berisha E., Malsiu M., 2019. Strategic Environmental Assessment, (SEA) Objectives for the Municipal Development Plan (MDP) of the Municipality of Shterpce. Medwell publications. Journal of Engineering and Applied. ISSN: 1816 -949X;
11. Komuna e Ferizajt 2016 Hartat e prezantuar në PZHK.
12. Emetimi i gazeve serrë në Kosovë 2008 – 2009; UNDP- Kosovë;
13. Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2008-2010;
14. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin; 2011 – 2020;
15. Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches;
16. Qendra Rajonale e Mjedisit. REC;
17. Plani Zhvillimor Komunal;